E hënë, 14 gusht 2023

[Seancë e hapur]

[Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

[I akuzuari Krasniqi paraqitet përmes videolidhjes]

--- Seanca fillon në orën 9.00

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes, të gjithëve. Mirë se keni ardhur.

Znj. Sekretare e Seancës, ju lutem thërrisni çështjen.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vërej që z. Krasniqi ka hequr dorë nga e drejta e tij për të qenë i pranishëm në sallë e gjyqit gjatë kësaj jave. Ndërkohë që kemi z. Thaçi, z. Veseli dhe z. Selimi të pranishëm në sallën e gjyqit.

Do të fillojmë me provat e Prokurorisë dhe marrjen në pyetje të Dëshmitarit 03879.

Z. Kehoe, doni që të ngrini diçka?

Z. KEHOE: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës. Mendoj që është me rëndësi që të ngre dy çështje dhe t’ia sjell ato në dijeni Trupit Gjykues të cilat kanë pasur një ndikim shumë shqetësues për Gjykatën. Dhe besoj që mënyra më e mirë për t’i

trajtuar këto dy çështje është që Trupi Gjykues të vendosë lidhur me to.

Pika e parë ka të bëjë me disa artikuj që janë botuar me ministrinë ruse, me ministrin rus të Punëve të Jashtme Maria Zakharova dhe janë artikuj të cilët janë botuar dhe janë pasqyruar gjithashtu edhe në median evropiane, deri në masën që kjo çështje ka të bëjë me trafikimin e organeve dhe se një prej udhëheqësve të UÇK-së është përfshirë me trafikimin e organeve njerëzore në këtë proces gjyqësor. Sigurisht, që kjo është absolutisht false, duke pasur parasysh akuzat që janë ngritur në kuadër të aktakuzës.

Dhe pavarësisht kësaj, këto lloj artikujsh të medias janë paragjykues ndaj të akuzuarëve. Në fakt, në qoftë se hetimi që ka të bëjë me trafikimin e organeve ka përfunduar, duhet që dikush në këtë godinë ta thotë këtë gjë, pra, që nuk ka asgjë në aktakuzat ose në akuzat e ngritura kundër të akuzuarve të cilat i lidhin të akuzuarit me trafikimin e organeve. Kjo duhet të bëhet e qartë. Nuk e di në qoftë se rusët po përpiqen që të ndikojnë këtë Trup Gjykues, por pavarësisht qëllimeve të tyre ata në mënyrë të vazhdueshme vazhdojnë të përpiqen që të thonë që zotërinjtë të cilët janë të akuzuar në këtë çështje gjyqësore janë të përfshirë në akuza për trafikimin e organeve, gjë e cila pa diskutim që nuk është e vërtetë. Ju parashtroj, të nderuar Gjykatës, që do të ishte mirë që ju të jepni një njoftim dhe të thoni që ky hetim ka përfunduar dhe

kjo çështje nuk ka të bëjë fare me trafikimin e organeve.

Në një tjetër çështje, që është po aq shqetësuese, është ndikimi mbi dëshmitarët që ka të bëjë me klientin tim, me presidentin Hashim Thaçi.

Ka shumë artikuj që janë botuar gjatë ditëve të mëparshme në Prishtinë dhe që janë reflektuar gjithashtu edhe në lajme në intervista të cilat janë transmetuar në mënyrë të drejtpërdrejtë që një person shqiptar, një individ shqiptar në Gjermani është takuar ose është kontaktuar nga Qeveria e Kosovës. Dhe thuhet që ky person në Gjermani, personalisht është kërkuar që të gjejë "katër dëshmitarë katolikë që të japë dëshmi në Gjykatën e Hagës kundër ish-presidentit të Kosovës Hashim Thaçi". Dhe ai citohet të ketë thënë që "Mua më është kërkuar që të gjej dëshmitarë katolikë kundër Hashim Thaçit". Dhe teoria është që dëshmitarët katolikë janë më të besueshëm se ata jo-katolik.

E kuptoj që ZPS-ja ka përdorur ndërmjetës në Prishtinë dhe në Kosovë për të gjetur dëshmitarë, megjithatë, kjo është ndërhyrje në procesin e drejtësisë në qoftë se ka pjesëmarrje që inkurajon dikë që të gjejë katër dëshmitarë katolikë dhe të vijnë dhe të dëshmojnë kundër klientit tim, klientit tonë, presidentit Hashim Thaçi.

Dua t'jua ngre këtë dhe t'jua bëj këtë me dije, të nderuar Gjykatës dhe besoj që është e drejtë të them që kjo ndërhyn në drejtësi, me çështjen e drejtësisë. Dhe për të qenë

i sinqertë, të nderuar Gjykatës, nuk kam asnjë vend tjetër ku t'i drejtohem me këtë shqetësim përveçse Trupit Gjykues.

Pra, këto ishin dy pika kryesore, dy pika shumë të rëndësishme për ne të cilat janë shumë shqetësuese, të cilat kanë ndodhur gjatë dhjetë ditëve të fundit dhe dëshiroja që këto çështje t'i sillja në vëmendjen tuaj, të nderuar Gjykatës dhe dëshiroj që ju të jepni udhëzimet tuaja lidhur me to, të nderuar Gjykatës.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit, z. Kehoe.

Jemi gati për dëshmitarin e parë.

I kërkoj Sekretares së seancës që të sjellë dëshmitarin në sallën e gjyqit.

Ju kujtoj të gjithëve që jemi në seancë publike.

Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ndërkohë që sillet dëshmitari, a është mirë që t'i përgjigjemi shqetësimeve të ngritura nga Mbrojtja e z. Thaçi?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

Një sekondë, znj. Sekretare, mos e sillni dëshmitarin.

Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kjo është një çështje e cila nuk është diskutuar me neve *inter partes*. Asnjë prej çështjeve të cilat u ngritën nga z. Kehoe, nuk ka të bëjë me dëshmitarin i cili do të vijë për të dëshmuar në sallën e gjyqit, kështu që kërkojmë që Mbrojtja e z. Thaçi t'i parashtrojë me shkrim këto shqetësime të tij.

Z. KEHOE: [Përkthim] Shkurtimisht, të nderuar Gjykatës. Gjykata dhe unë si avokat kërkoj disa shpjegime. Në qoftë se dua që të jepen disa shpjegime, në qoftë se janë kërkuar dëshmitarë nga dikush që i cili është i paraqitur, është i pranishëm në këtë sallë gjyqi duam, kërkojmë disa shpjegime lidhur me këtë.

Sa i takon parashtrimeve me shkrim, do ta bëjmë këtë gjë, megjithatë, dua të them, që vërtetë kjo është shqetësuese se dikush është jashtë atje duke kërkuar dëshmitarë katolikë për të dhënë dëshmi kundër z. Thaçi, kjo në të vërtetë është shqetësuese.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë, besoj se do të dorëzoni një parashtrim me shkrim në qoftë se doni që ne të japim udhëzime. Besoj që na kuptoni që ne nuk kemi kontroll, se kemi shumë pak kontroll mbi atë se çfarë dëshiron që të shkruajë shtypi. Por, në qoftë se ju mendoni që ne kemi ndonjë përgjigje për të dhënë lidhur me shqetësimin tuaj, sigurisht, që do ta kuptojmë këtë dhe sigurisht që do të japim udhëzimet përkatëse.

Z. KEHOE: [Përkthim] Po, faleminderit.

[Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Qëndroni në këmbë, ju lutem.

Mirëmëngjes, Dëshmitar. Më dëgjon?

DËSHMITARI: Po, ju ndëgjoj. Mirëmëngjesi.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Sekretare do t'ju japë tekstin e deklaratës solemne që do t'ju kërkohet që të lexoni në pajtim me rregullën 142(2)[sipas përkthimit] i rregullores. Kur të jeni gati, ju lutem lexojeni me zë të lartë deklaratën që keni përpara.

DËSHMITARI: I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe nuk do të mbaj të fshehur asgjë për të cilën kam dijeni.

DËSHMITARI: W03879

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit, Dëshmitar. Uluni, ju lutem.

Dëshmitar, sot do të fillojmë me dëshminë tuaj e cila pritet që të zgjasë katër deri në pesë ditë. Juve sapo lexuat deklaratën solemne. A e kuptoni atë çfarë lexuat?

DËSHMITARI: Po.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A pajtoheni me të?

DËSHMITARI: Po.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sikurse mund ta dini, Prokuroria do t'ju bëj së pari pyetje dhe pastaj do të bëjë pyetje Avokati i Viktimave. Pasi të kenë përfunduar Prokuroria dhe Avokati i Viktimave do të bëjnë pyetje Avokatët e të të akuzuarëve. Edhe Trupi Gjykues mund t'ju bëj pyetje.

Vlerësimi i kohës së Prokurorisë për t'ju marrë në pyetje

është tetë orë. Mbrojtja e Viktimave do të përdorë thuajse 15 minuta për pyetjet, ndërkohë që Mbrojtjet vlerësojmë që do t'ju duhet 13 orë për t'ju marrë në pyetje. Shpresojmë, si dhe në rastet e tjera, që palët të përdorin me efikasitet kohën në Gjykatë.

Dëshmitar, mundohuni të jepni përgjigje qartë pyetjeve që do t'ju bëhen me fjali të shkurtra. Nëse nuk e kuptoni një pyetje të caktuar, ju lutem lirisht kërkojini avokatit që ta përsërisë sërish pyetjen ose thojini atij që nuk e kuptoni pyetjen dhe pala përkatëse do ta sqarojë pyetjen. Ju lutem, na thoni se cila është baza për njohuritë, faktet dhe rrethanat për të cilat do të pyeteni.

Ju lutemi, po ashtu flisni përpara mikrofonit dhe prisni pesë sekonda përpara sesa t'i përgjigjeni një pyetjeje. Po ashtu ju lutem flisni në ritëm të avashtë në mënyrë të tillë që përkthyesit t'ju kapin.

Gjatë ditëve në vijim kur do të jepni dëshmi në këtë sallë gjyqi, nuk lejoheni që të diskutoni me askënd përmbajtjen e dëshmisë së dhënë përpara Trupit Gjykues për palë të tjera jashtë Trupit Gjykues dhe jashtë sallës së gjyqit. Në qoftë se ndokush jashtë sallës së gjyqit ju kërkon informacion lidhur me dëshminë tuaj, ju lutem tregojini Trupit Gjykues lidhur me këtë.

Ju lutem nëse unë ju kërkoj që të ndaloni së foluri ndaloni së foluri, po ashtu edhe në qoftë se e shikoni se unë

ngre dorën, ndaloni së foluri. Kjo do të thotë, në qoftë se unë ngre dorën, pra, do të thotë që më duhet t'ju jap udhëzime të tjera.

Nëse e mendoni të arsyeshme se ju nevojitet një pushim, ju lutem na e thoni këtë gjë.

Përpara sesa të fillojmë, me ç'kuptoj ka një pajtim të ndërsjellët që Mbrojtja e Selimit do fillojë së pari, pra, nga ekipet e Mbrojtjes së Viktimave me pyetje për ju. A ka ndonjë kundërshtim nga Mbrojtja e z. Thaçi ose Mbrojtjet e të akuzuarve të tjerë?

Z. KEHOE: [Përkthim] Jo, nuk kemi.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbrojtja e z. Krasniqi, kemi ndonjë kundërshtim?

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Jo, nuk kemi.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull, atëherë. Ashtu do të procedojmë, pra, Mbrojtja e z. Krasniqi do t'ju bëj pyetjet e para nga ekipet e Mbrojtjes.

Z. Prokuror, mund të vazhdoni.

Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

Pyetje nga z. Halling:

Z. HALLING: [Përkthim]

PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar. Dëshmitar, do të fillojmë fillimisht me disa pyetje të përgjithshme.

Z. HALLING: [Përkthim] Dhe për shkak të faktit të natyrës identifikuese të pyetjeve që do të bëjë, do kërkoja që të

kalojmë në seancë private.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Sekretare, të kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë të hapur.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Vazhdoni, Prokuror.

Z. HALLING: [Përkthim] Ju faleminderit.

PY. Dëshmitar, po flisnim më përpara në seancë private për shtabin e Llapushnikut. Unë dua t'ju tregoj disa fotografi.

Z. HALLING: [Përkthim] Dhe për këtë do i kërkoja Sekretares që të nxjerrë në ekran dokumentin IT-03-66 P6 dhe më konkretisht faqen U0003-32456.

PY. Dëshmitar, për një çast në ekran do të dalë një fotografi dhe do ju bëj disa pyetje lidhur me fotografinë që do të shihni. Dëshmitar, e shef fotografinë përpara?

PË. Po.

PY. Lart thuhet, në anglisht thuhet "Kompleksi i fermës së Llapushnikut". Pyetja që kam unë është këtu në këtë fotografi e dalloni shtabin e Llapushnikut?

PË. A e preki me laps?

PY. Ndërtesat janë me numër, mund të na e thoni me numër cila është ndërtesa mund të mjaftojë, po të na thoni cili numër i përkon ndërtesës që ka qenë shtabi i Llapushnikut?

PË. Numri 2. Simbas meje numri 2.
PY. Po ke ndërtesat e tjera që janë në këtë fotografi ke shikuar ndonjëherë nga maji deri në korrik të 1998?
PË. Jo. Është pamja ndoshta ka qenë ndryshe. Nuk ju kam sjellë rreth e rrotull, nuk besoj që jam kanë tek këto të tjerat. Jo.

Z. HALLING: [Përkthim] Do i lutesha Sekretares të shkojmë në faqen tjetër që është faqja me numër U003-2457.

PY. Dëshmitar, besoj se kjo është e njëjta fotografi po nga një kënd tjetër. E sheh numrin 2 nga e djathta e ekranit?
PË. Po.
PY. I përkon kjo, pra, kjo fotografi shtabit të Llapushnikut ky numër?
PË. Nuk po jem i kjartë. Nuk muj me e supozu. Se tash prej kësaj ane unë nuk kam –- nuk muj me ka i kjartë.
PY. Është e drejtë të them që shtabi i Llapushnikut nuk duket shumë, pra, në ekran, nuk është e qartë, pra, kjo është, ky duhet të ishte shtabi i Llapushnikut, mund të themi kështu?

Z. KEHOE: [Përkthim] Kundërshtoj.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet kundërshtimi.

Dëshmitar, mund t'i përgjigjeni pyetjes.

DËSHMITARI: Po më duket se derisa ku është shigjeta ashtu ka qenë objekti, ku përfundon shigjeta. Ashtu po më duket se kjo pamja ka qenë.

Z. HALLING: [Përkthim]

PY. Faleminderit.

Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne besojmë se kjo është një përgjigje e vlefshme dhe autentikimi është i vlefshëm lidhur me fotografitë dhe kërkonim që të pranohej. Ky është një grupim fotografish nga çështja që ka pasur ish-Tribunali në çështjen Limaj. Është e qartë që nuk e kemi treguar më përpara të gjitha fotografitë, kuptohet. Por, duke pasur parasysh këtë që sapo diskutuam, do të kërkonim që të pranohesh i gjithë grupimi i fotove. Nëse ka ndonjë kundërshtim atëherë ne kërkojmë që të pranohen vetëm dy fotografitë që sapo shfaqën.

Z. KEHOE: [Përkthim] Ne i kundërshtojmë të gjitha. ZPS-ja dëshiron që ne të pranojmë si prova disa fotografi dhe dëshmitari nuk është as i sigurtë që numri 2 në fotografi i përkonte fotografisë. Kjo është e paqartë. Edhe nuk ka pasur as ndonjë pyetje të qartë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar].

Z. KEHOE: [Përkthim] E kundërshtoj. E kundërshtoj. E kundërshtoj edhe fotografinë numër 2.

Z. HALLING: [Përkthim] Atëherë ne kërkojmë të pranohen si prova vetëm dy fotografitë.

Z. KEHOE: [Përkthim] Jo, jo. Ne e kundërshtojmë. Pranoni fotografinë numër 1. Po ne kundërshtojmë fotografinë numër 2.

Nuk ka baza për ta pranuar si provë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë gjë nga ekipi i Mbrojtjes së Veselit?

Z. ROBERTS: [Përkthim] Asgjë.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Asgjë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] 1 dhe 2 do të pranohen si prova. Mjaftojnë.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Fotografitë përkatësisht me numrin U003-2456 dhe U003-2457 do të shënohen si prova materiale P255.

Z. HALLING: [Përkthim] Për procesverbal këto prova materiale mund të jenë publike.

PY. Dëshmitar, në seancë private folëm për ceremoninë e betimit të UÇK-së. Unë kam një video që dua t'jua tregoj, do t'jua shfaq.

Z. HALLING: [Përkthim] Për këtë do i kërkoja Sekretares të nxjerrë në ekran videon me numër 061427-25. Dhe minutazhi që na intereson është konkretisht minuta 1, 50 sekonda deri në minutën e dytë, 45 sekonda.

[Trupi Gjykues dhe Sekretarja e Gjykatës këshillohen]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshironi që të jetë në seancë të hapur?

Z. HALLING: [Përkthim] Po, kjo mund të jetë në seancë të hapur.

Para se të transmetohet videoja besoj se për përkthyesit do të ishte e dobishme të thoshim që nuk ka shumë fjalë videoja dhe kryesisht na interesojnë imazhet. Sugjerojmë që vetëm të transmetohet videoja, të mos përkthehet dhe pastaj mund t'i lexoj unë të gjitha fjalët pasi të mbaroj videoja. Është kjo, mjafton kjo?

Z. KEHOE: [Përkthim] Sa i takon kësaj videos, unë e kuptoj që videoja nuk ka qenë ceremonia e betimit të këtij dëshmitarit këtu. Kështu e kam kuptuar unë të paktën. Nëse është kështu është jorelevante dhe s'duhet pranuar.

Z. HALLING: [Përkthim] Po unë akoma s'kam kërkuar që të pranohet që të pranohet videoja. Unë thjesht them që në mënyrë provizore të pranohet, përkohësisht, të pranohet si provë materiale sipas rregullës 154 për një dëshmitar tjetër. Do ta pyes dëshmitarin për këtë.

Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk është ceremonia e betimit të dëshmitarit konkret. Nuk ka asnjë bazë për ta shfaqur këtë video dhe Prokurori e di këtë. Nëse do t'i bëjë pyetje për ceremoninë e betimit ku ka qenë ai i pranishëm, në rregull, s'kemi kundërshtime. Po kjo video konkrete nuk është me rëndësi. Sepse është për një dëshmitar tjetër dhe kur të vijë ai dëshmitari dakord le ta shfaqim, po s'është ky dëshmitar.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

Z. HALLING: [Përkthim] Atëherë, çfarë propozoj, e pranojmë që nuk është ceremonia e betimit të këtij dëshmitari,

por ky dëshmitar mund të na japë informacion me vlerë provuese dhe unë mendoj që kjo buron nga Shënimi Përgatitor 2, 114611, 114614, paragrafi 18, sepse është përgatitur për këtë dhe do t'i japim mundësinë dëshmitarit që të komentojë para se të merret vendim përfundimtar për pranimin.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kam --

Z. KEHOE: [Përkthim] Po lexoj diçka më jepni pak kohë, ju lutem.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po cili është qëllimi i kësaj ceremonie betimi?

Z. HALLING: [Përkthim] Po nuk e kemi ceremoninë e betimit të këtij dëshmitari, po kemi një ceremoni tjetër që është e ngjashme dhe mund të jetë një përvojë e ngjashme me atë që ka pasur dëshmitari. Nëse mund të na tregojë diçka dëshmitari lidhur me këtë, ne gjykojmë që kjo është e rëndësishme sepse ka vlerë provuese.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë le ta shohim videon dhe pastaj vendosim a do pranohet apo s'do pranohet.

Z. HALLING: [Përkthim] Edhe njëherë na nevojitet nga minuta, pra, 1 minutë, sekonda 50 dhe pastaj me -- sekonda e 45.

[Luhet videoincizimi]

Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, Sekretare.

Për procesverbal, fjalët që u thanë në fillim është nga

transkripti i anglishtes thuhet:

"Tërheqim vëmendjen. Përshëndetje, z. Komandant. Kompania është gati për të ngritur flamurin kombëtar dhe për të bërë betimi. Raporton Kumanova".

Dhe në fund të videos, thanë:

"Ushtarët dhe oficerët".

PY. Dëshmitar, që ta sqarojmë, kjo nuk është ceremonia e betimit për të cilën folëm në seancë private apo jo, nuk është ceremonia juaj e betimit për të cilën folëm në seancë private, kështu?

PË. Ashtu.

PY. Tani kur kjo ceremonia e betimit në video a është e ngjashme apo a mund të krahasohet me ceremoninë e betimit për të cilën folëm bashkë në seancë private?

PË. E ngjajshme.

PY. Ato hapat që pamë në video, a ishin njësoj dhe në ceremoninë e betimit që përshkruat ju?

PË. Po.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prokuror, po thoni që u bë gjë betim aty?

Z. HALLING: [Përkthim] Ne mendojmë që është një video e një ceremonie betimi.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po aty s'ka ndonjë betim.

Z. HALLING: [Përkthim] Po betimi nuk është në pjesën e

regjistruar, po do i kërkoja Sekretares që të ndalojë tek pjesa minuta e dytë, sekonda e nëntë.

PY. Dëshmitar, nga e majta në të djathtë, nëse i njihni a mund të m'i thoni kush janë këta persona?

PË. I pari është me mustaqe Musë Jashari. I dyti është Fatmir Limaj. I treti është Kumanova, Ismet Jashari.

PY. Këta ishin dhe tre personat të pranishëm në ceremoninë e betimit që diskutuam në seancë private, kështu?

PË. Po.

Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, duke pasur parasysh identifikimin që bëri dëshmitari edhe duke thënë se duke pasur parasysh se është pranuar në mënyrë të përkohshme si provë materiale shoqëruese për një dëshmitar tjetër, ne mendojmë që është e përshtatshme që kjo të pranohet si provë materiale dhe ne parashtrojmë kërkesën ime.

Z. KEHOE: [Përkthim] Doni të pranojmë një regjistrim për një betim ku s'ka betim konkretisht. Thonë që është e njëjta, po ama s'është e njëjta.

Prokuroria thotë që një dëshmitar tjetër mund ta verifikojë këtë dhe ta autentikojë këtë. Në rregull. Kur të vij ky dëshmitar le ta bëjë. Por kjo video s'ka fare lidhje me këtë dëshmitar përveç faktit që Musë Jashari, Fatmir Limaj kanë qenë të pranishëm atje dhe Ismet Jashari. Dhe po ju tregoni si duken ceremonitë e betimit të UÇK-së. Ishin shumë efikase. Por, ama betim s'ka aty. Kështu që kjo pjesa më e

rëndësishme nuk është në video.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet. S'ka asnjë lidhje në këtë video, asgjë të na tregojë për ndonjë betim konkret aty. Kjo është e pavlerë kjo video.

Z. HALLING: [Përkthim] Në rregull, atëherë.

DËSHMITARI: A do të muj të shtoj diçka?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk e dimë çfarë doni të thoni.

Z. HALLING: [Përkthim]

PY. Dëshmitar, po thoni çfarë keni për të thënë.

PË. Deshta të them se videot tona ku kam qenë që jemi, kemi qenë prezent, ato asnjëherë nuk janë shfaqë. Ato janë zhdukun për qëllime të caktune. Në betimin kur e kemi dhënë të njëjtë sikur ky, veç ka pasë ushtarë ma shumë. Edhe incizimi nuk është shfaqë asnjëherë për qëllim të caktum.

PY. Ju faleminderit, Dëshmitar.

Z. HALLING: [Përkthim] Duke qenë se kemi një dëshmitar tjetër që do të flasim edhe me këtë video atëherë mund ta lëmë për momentin dhe të flasim më vonë. Video mund të hiqet nga ekrani.

PY. Dëshmitar, sa i takon kyçjes në UÇK ka pasur rregulla zyrtarë për të qenë pjesë e UÇK-së?

PË. S'e kuptoj.

PY. Për shembull, a ka pasur mënyra të caktuara sesi duhet të silleshin ushtarët dhe këto a u komunikoheshin ju, rregullat

që duhet të ndiqnit?
PË. Ka pasë rregulla. Ka pasë që duhet me i përcjellë, duhet me i zbatu.
PY. Kur ju komunikoheshin, pak a shumë, pas ceremonisë së betimit që diskutuam në seancë private, kur ju janë dhënë, kur ju janë thënë rregulla?
PË. Rregullat i kemi ndëgju prej Imer Alushanit, Çerçizit, prej këtyne që duhet me pasë rregulla. Po a janë zbatu a s’janë zbatu, nuk janë zbatu në tërësisht.
PY. Ju thatë që keni dëgjuar. Po me shkrim a u kumtuan ndonjëherë këto rregulla, a u dhanë ndonjëherë?
PË. Jo, asnjëherë.
PY. Dua të flasim pak për strukturën e komandës në zonën e Llapushnikut. Do fillojmë me Fatmir Limajn. Çfarë roli kishte Fatmir Limaj në strukturën e komandës së Llapushnikut?
PË. Ky ka qenë komandanti kryesor për atë zonë.
PY. Faleminderit. Që ta sqarojmë, për të gjitha pyetjet që do kem bëhet fjalë për periudhën maj deri në korrik të 1998. Gjatë kësaj kohe ku ishte i vendosur Fatmir Limaj, ku qëndronte?
PË. Ky ka qëndru në Kleçkë.
PY. Më vonë gjatë luftës, a e ke idenë se cila brigadë me cilin numër ishte e vendosur në zonën e Kleçkës, brigada, pra, me cilin numër ishte e vendosur në zonën e Kleçkës?
PË. 121.

PY. Po flisnim për Çerçizin, Isak Musliu. Na tregoni çfarë roli kishte ky person në strukturën komanduese të Llapushnikut në atë kohë?

PË. Ky ka qenë komandant në zonë të Llapushnikut.

PY. Kë kishte zëvendëskomandant?

PË. Zëvendëskomandant ka pasun Shefqet Buçën, Mësuesin dhe Imer Alushanin. Këta të dytë kanë qenë afër tij.

PY. Shefqet Buçi, si e kishe nofkën gjatë luftës?

PË. Mësuesi.

PY. Që ta kuptojmë strukturën e komandës së Llapushnikut, pra, në krye ishte Fatmir Limaj, pastaj Isak Musliu dhe pastaj ishte Imer Alushani edhe Shefqet Buçi. E përshkruam kështu ishte linja komanduese, zinxhiri komanduese?

PË. Po.

Z. STRONG: [Përkthim] Besoj se meqë po diskutojmë strukturën komanduese, do të na shërbente të dinim dhe ku e ka të bazuar dijeni në lidhur me këtë strukturën komanduese.

Z. HALLING: [Përkthim] Besoj se është e qartë, po pyetjen më konkrete mund t'ia bëjmë në seancë private pastaj për ta marrë këtë informacion.

PY. Isak Musliu mund të nxirrte urdhëresa dhe a mund t'u jepte detyra ushtarëve?

PË. Po, gjithsesi.

PY. Urdhëresat mund të komunikoheshin nga Fatmir Limaj te Imer Alushani dhe pastaj te Shefqet Buçi për t'ju përcjellë

pastaj ushtarëve, kështu shkonte?
PË. Po.
PY. Kemi folur për përcjelljen e urdhrave përmes zinxhirit komandues. A ndiqej e njëjta linjë komanduese po me drejtim nga poshtë lart për të raportuar çfarë kishte ndodhur, përmes të njëjtit zinxhir komandues shkonte nga poshtë-lart?
PË. Po.
PY. Ke dijeni në qoftë se kishte ndonjë person tjetër mbi Fatmir Limaj që të kishte pushtet në zonën e Llapushnikut apo kompetenca për zonën e Llapushnikut, ndonjë më të madh se Fatmir Limaj?
PË. Jo. Unë për atë fillim nuk kam ndëgjue.
PY. Dëshmitar, ke dëgjuar ndonjëherë për ndonjë person me emrin Shukri Buja?
PË. Po.
PY. Kush është Shukri Buja?
PË. Shukri Buja ka qenë në një pjesë tjetër me të Krojmirit të fshatrave aty afër Krojmirit. Komandant me Luanin. Tash mu ngatërrue emni i këtina. Qeriqi, Ramiz Qeriqi. Këta të dytë kanë qenë në atë zonë. Pastaj kanë dalë edhe në zonën tjetër ku janë bë që e kanë marrë përsipër zonën e Vërshecit.
PY. A dini në qoftë se Shukri Buja ka pasur ndonjë nofkë gjatë luftës?
PË. Gazetari.
PY. A është a do të thotë "Gazetar", domethënë, në shqip kjo

fjalë, "journalist" në anglisht?
PË. Po, po.
PY. Në seancë private folëm për Gani Kastratin dhe Fadil Kastratin. Pa dhënë informacion lidhur me mënyrën sesi i njihni këta persona, a e dini në qoftë se të dy personat kanë vepruar nën autoritetin e Shukri Bujës, pra, në qoftë se Shukri Buja u ka dhënë urdhra këtyre dy personave?
PË. Po, e qartë.
PY. Gjatë kësaj kohe, domethënë, në periudhën nga maji deri në korrik të 1998, si komunikoheshin urdhrat e UÇK-së?
PË. Përmes komandës. Secili i kish dikënd më të naltë dhe raportonke te ai, te komandanti i vetë.
PY. Urdhrat a komunikoheshin edhe me gojë edhe me shkrim?
PË. Vetëm me gojë. Ka pasë edhe raste tjera që i kanë shkru për ndonjë person që ka ndjek penalisht ose diçka që i kanë pasë ato. Kanë pasë mundësi. Unë s'i kam pasë ato.
PY. UÇK-ja a përdorte radiolidhje në atë kohë për të komunikuar?
PË. Po, ka pasë. Dikush ka pasë ma të mira, dikush shumë të thjeshta.
PY. Dëshmitar, tani dëshiroj të tregoj një dokument dhe pasi ta shikoni dokumentin dëshiroj që t'ju bëj disa pyetje lidhur me të.
Z. HALLING: [Përkthim] Është dokumenti që mban numrin e identifikimit U008-1633 deri në U008-1633-ET. Është deklarata

politike numër 8 e UÇK-së. Të nderuar Gjykatës, ky është një dokument i cili është pranuar si pjesë e vendimit të pranimit të provave jo gojore. Është parashtrimi i protokolluar 1705, paragrafi 35, megjithatë nuk i është caktuar akoma një numër i provës materiale.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar].

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Sigurisht, të nderuar Gjykatës, është prova materiale P256.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë, do t'i drejtohemi këtij dokumenti duke përdorur numrin e provës materiale.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] A ekziston një version në gjuhën shqipe të këtij dokumenti?

Z. HALLING: [Përkthim] Versioni në shqip është pjesë e dokumentit U008-1602 dhe dokumentit U008-1636, në të njëjtën faqe.

PY. Dëshmitar, ky dokument iu tregua dhe javës që shkoi gjatë përgatitjes tuaj. A e kam të saktë informacionin që ju gjatë luftës nuk e keni parë këtë dokument asnjëherë?

PË. Jo, asnjëherë s'e kam pa.

PY. Dua t'ju lexoj një pjesë të këtij dokument dhe pasi ta lexoj këtë pjesë dua t'ju bëj disa pyetje lidhur me këtë.

"Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe populli shqiptar janë duke u goditur tani prapa shpine nga elementë kolaboracionistë

dhe pacifistë. Me gjithë vështirësitë UÇK-ja e dalë nga gjiri i popullit në flakën e luftës për liri do të vazhdojë luftën deri në fitore”.

Dëshmitar, pyetja që kam për ju është kjo, sa e përhapur -- sa i përhapur ishte kjo lloj ndjesie në zonën e Llapushnikut nga maji në korrik të vitit 1998?

PË. Menjëherë pasi kemi shku në Llapushnik, kanë fillu të deklarohen disa ushtarë pa uniformë, veç thjesht kanë qenë, as nuk e njofshin Rugovën, thojshin “Menjëherë shallin, ta kishim zënë shallin”. Unë nuk e kuptova në fillim kush është shalli, për çka me nxënë shallin, kur na ishim hi me qëllim me luftu me forcat serbe. Pastaj e kuptova se është fjala për Rugovën, ai pengesë e tyne paska qenë Rugova.

Na kemi qenë pjesë e LDK-së deri shumë vonë mbas luftës, atëherë njëfarëlloj shije, si një lloj presioni që kemi pasun, ka qenë edhe ky motiv, që njerëzit e LDK-së pse janë kyç në UÇK apo kanë mendu këta njerëz ç’ka janë kanë në fillim. Se vetëm këta duhet me udhëheq luftën, e vetëm këta duhet me kanun, me e zotnu Kosovën, e ashtu diçka.

PY. Dëshmitar, atëherë kjo çfarë thuhet në dokument, “që goditen prapashpine nga element kolaboracionistë dhe pacifistë”, ju këtë e lidhni me LDK-në apo jo?

PË. Po.

PY. Në periudhën kohore për të cilën kemi diskutuar, ushtarët e UÇK-së a ju thuhej atyre që ata të mendonin ose të kishin

përshtypjen që LDK-ja ishte armik?
PË. Në shumë raste ka pasë që nuk duhet me i pranu. Që kam dëgju prej pjesës time. "Nuk duhet me i pranu. Nuk janë të besueshëm", ashtu.
Z. KEHOE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të na thuhen se kush e ka thënë këtë gjë? Pra, kush i ka dhënë këto komente dhe të mos hidhet kështu si ide e përgjithshme kjo që u tha.
Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, përderisa jemi në seancë të hapur propozoj që ta bëj këtë pyetje në seancë private, kur të kalojmë në seancë private ose mund të kalojmë tani në seancë private dhe ta bëjmë pyetjen.
KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar].
Z. HALLING: [Përkthim] Do bëj pyetje për sa i takon bazës së informacionit në momentin kur të kalojmë në seancë private.
KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jam i sigurtë që z. Kehoe do të na kujtojë në qoftë se ju harroni të bëni ndonjë ndër pyetjet për të përcaktuar bazën e informacionit.
Z. HALLING: [Përkthim]
PY. Duke folur në nivel të përgjithshëm, a i përhapte këto mesazhe edhe komanda e UÇK-së?
ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Është një pyetje udhëzuese, të nderuar Gjykatës.
KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet,

vazhdoni.

Z. HALLING: [Përkthim]

PY. Mund t'jua përsëris edhe një herë pyetjen: Duke folur në nivel të përgjithshëm, a ishte komanda e UÇK-së ajo i përhapte këto mesazhe?

PË. Po mendoj që e UÇK-së ka qenë sigurisht, se nuk kish mujt me fol dikush kur e ka pasur shumica prej luftëtarëve kanë qenë LDK. Atëhere ka pasur kundërshtime këtu. A u pa kjartë ndjekja e jonë, e atyne tjerëve, veprimi i tyne, sjellja e tyne ndaj njerëzve të LDK-së. Atëherë u pa kjartë se kanë mujtë me pasë kundërshtime ata me thanë "Jo, kjo nuk vazhdon kështu. Duhet me u ndërpre, nuk kem na të bëjmë me LDK-në". Vetë janë duht me u deklaru ata.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, të nderuar Gjykatës. Po reflektoj për disa nga kundërshtimet që janë ngritur deri tani. Ka një problem që t'i kërkohet dëshmi të mbështetur në opinione për këtë dëshmitar dhe pastaj të kalojmë më vonë në seancë private dhe pastaj të bëjmë pyetjet të cilat kanë të bëjnë me bazën e njohurisë së personit. Kështu që, kjo pyetje në qoftë se, pra, i referohemi pyetjes që bëri më përpara Prokurori, që thotë në qoftë se një mesazh mund të ketë ardhur nga komanda?

Mendoj që një lloj pyetje e tillë nuk duhet të lejohet, në qoftë se nuk pasohet me pyetje të tjera të cilat përcaktojnë bazën e njohurisë. Domethënë, me fjalë të tjera,

në qoftë se, së pari do të trajtojmë pyetjet e përgjithshme dhe pastaj pas ca kohe të kalojmë në seancë private për bazën e pyetjeve nuk është shumë e qartë. Domethënë, në qoftë se është e nevojshme, mendoj që të bëhen pyetjet e përgjithshme në seancë të hapur, pastaj le të kalojmë në seancë të mbyllur në mënyrë të tillë që të mund të përcaktojë se cila është baza e njohurisë së dëshmitarit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet. Do të bëjmë këtë gjë, pra, do të bëjmë pyetjet e përgjithshme në seancë të hapur, pastaj do të kalojmë në seancë të mbyllur në mënyrë të tillë që të bëhen pyetjet për bazën e njohurisë së dëshmitarit.

Znj. Sekretare, ju lutem na kaloni në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

--- Pauza fillon në orën 11.00

--- Seanca rifillon në orën 11.29

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Uluni, ju lutem.

Zonja Sekretare, mund të sillni dëshmitarin në sallë.

Ju kujtoj të gjithëve që jemi në seancë publike.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do të vazhdojmë me marrjen në pyetje nga Prokuroria.

Vazhdoni, z. Halling.

Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës. Për grupin tjetër të pyetjeve, kërkojmë që të kalojë në seancë private.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Sekretar, ju lutem të kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë pushimin e drekës deri në orën 14.30.

--- Pauza filloi në orën 12.59

--- Seanca rifillon në orën 14.30

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare, mund të sillni Dëshmitarin.

Z. HALLING: [Përkthim] Dua të bëj një sqarim për procesverbal përpara se të hyjë dëshmitari në sallën e gjyqit.

Faleminderit. Betimi konkret në videon që pamë sot paradite është 061427, [Sipas përkthimit] edhe është minutazhi 04:03 dhe 06:13. Ne thamë që nuk ishte kjo pjesa që na interesonte fillimisht, por do të kemi një dëshmitar tjetër pak më vonë që mund të flasë konkretisht për videon që sapo thamë. E thashë këtë për sqarim edhe për procesverbal.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH:

[Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar] Ka ndonjë ndryshim të kohës që keni parashikuar për këtë dëshmitar?

Z. HALLING: [Përkthim] E sigurt që nuk mbaroj sot, do më duhet seanca e parë nesër, por mbase edhe seanca e dytë, por tetë orë mbetet koha që na nevojitet deri tani.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëdita, Dëshmitar.

DËSHMITARI: Mirëdita.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jemi gati të vazhdojmë. Vazhdojmë me pyetjet e Prokurorisë, konkretisht.

Prokuror, mund të vazhdoni.

Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

PY. Dëshmitar, a më dëgjon?

PË. Po.

PY. Do të doja të vazhdonim me dëshminë tuaj.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

Z. HALLING: [Përkthim] Në fakt sapo do të kërkoja që të kalonim në seancë private.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. Seanca mbyllet për sot, dhe shihemi nesër në orën 9.00 të paradites. Ju faleminderit.

--- Seanca mbyllet në orën 15.59